



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

VENDIM NR 162 Datë 30.12.200

Për përdorimin e Fondit Rezervë, nga Granti & Të Ardhurat”

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, duke u mbështetur në ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe dhe ligjit nr.88/2019 datë 18.02.2019 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2020”, i miratuar me vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër nr.140 datë 26.12.2019, i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Dibër me vendimin , nr.16/1 prot. datë 17.01.2020, duke u bazuar në kërkesën e ardhur nga një grup mjekësh nëpërmjet projektit “Mjekë për Dibrën”, ku Spitali Rajonal Peshkopi synon që të tërheqë mjekë të rinj sipas specialiteteve përkatëse për të ushtruar veprimtarinë e tyre në varësi të nevojave të spitalit. Po i drejtohem këshilli bashkiak për mbështetjen ndaj këtij grupi të mjekëve për miratimin e bonusit të qerasë në masën 50% të vlerës për mjekë specialistë të afruar në qytetin e Peshkopisë: Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij, vendosi me datë 30.12.2020 me 20 vota pro 0 vota kundër 0 vota apstenim.

VENDOSI :

1. Nga fondi kontigjencës i buxhetit të Bashkisë Dibër, t’i jepet ndihmë për bonus qeraje grupit të mjekëve që punojnë në qytetin e Peshkopisë pranë Spitalit Rajonal Peshkopi.
2. Pakësohet të ardhurat për strukturën **1810** në vlerën 960.000 (nëntëqind e gjashtëdhjetëmijë) lekë dhe shtohet struktura **1110** llogaria **604** ne vleren 960,000 (nëntëqind e gjashtëdhjetëmijë) leke.
3. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Financës pranë Bashkisë Dibër.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas shprehjes për bazueshmëri ligjore nga institucioni i Prefektit të Qarkut Dibër.

